



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1111 /2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Esat Beka deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës në Vushtri paraqitur kundër, Komisioni Qendror Zgjedhor, për shkak publikimit të rezultateve, për kandidat të asamblesë, në raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Esat Beka Kandidat në K.K. në Vushtri nga subjekti subjekti politikë Partia Demokratike e Kosovës (PDK) . dega në Vushtri

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, pretenduesi ka theksuar se dyshimet e bazuara janë gjatë procesit të numërimit në Qendrën e Numrimit më janë zvogëluar votat dhe numri i tyre kalon 40 . Në numrin tim që e kamë bërë personalisht nëpër qendrat e numërimit nga formularët të publikuar nëpër dyert e vendvotimeve unë konstatoj se jam i votuar me mbi 260 vota pa tri qendra votimi, dhe 4 vend votime në dy qendra . Në KKZ gjat numërimit të votave nga formulari del se i posedoj mua mu numërohen 251 dhe tani në rezultatet e publikuara KQZ – ja shpallur vetëm 215 vota .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtuar të Esat Beka kandidat nga Subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Vushtri, pala ankuese pretendon gjatë procesit të numërimit në Qendrën e Numrimit më janë zvogëluar votat, gjegjësisht është bërë manipulim me votat e tija dhe numri i tyre kalon 40, për këtë qështje parashtuesi i ankesës nuk ka ofruar prova të mjaftueshme më të cilën do të vertetohej se është kryer një veprim i tillë, andaj PZAP-i konstatoi se i tillë është i pabazuar dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 1111 /2013 më datën 06.12 .2013.



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*